



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:178270  
Datë: 05.12.2024  
Numri i dokumentit: 06551293

Pml.nr.728/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve A. B. dhe A.1 B.1, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i pandehuri Arbër Berisha edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.124/2024 të datës 04.11.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1143/2024 të datës 15.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me pranimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve A. B. dhe A.1 B.1, ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.124/2024 i datës 04.11.2024 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1143/2024 i datës 15.11.2024, ashtu që ndaj të pandehurve ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lëshohen për t'u mbrojtur në liri.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.124/2024 e datës 04.11.2024, të pandehurit A. B. dhe A.1 B.1, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, i pandehuri A. B. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, i ka shpallur fajtorë dhe: të pandehurit A. B. për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, ia ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.04.2024 e tutje, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, ia ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 2.500€ (dymijepesëqind euro); ndërsa të pandehurit A.1 B.1, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, ia ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 04.06.2024 e tutje.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.124/2024 e datës 04.11.2024, të pandehurve A. B. dhe A.1 B.1, për shkak të veprave penale për të cilën janë shpallur fajtorë, ua ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me aktgjykim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.1143/2024 e datës 15.11.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të pandehurit A. B., avokati Fanol Fanol R. Krasniqi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 366 par.3 dhe nenit 184 të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen , ashtu që ndaj të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti të lëshohet në liri; dhe

- mbrojtësja e të pandehurit A.1 B.1, avokate Saranda Keqekolla Sadiku, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 366 par. 3 dhe nenit 184 të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen , ashtu që ndaj të pandehurit të ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti të lëshohet në liri.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.311/2024 e datës 27.11.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësit e të pandehurve theksojnë se aktvendimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale me rastin e vazhimit të masës së paraburgimit, ngase në aktvendimet e kundërshtuara nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe konkrete lidhur me masën e paraburgimit e po ashtu nuk ka prova dhe as fakte me të cilat do të dëshmohej më konkretisht se me të vërtetë të pandehurit do të fshihen apo të ikin dhe përsërisin veprën penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të bazuara. Të pandehurit e kanë pranuar fajësinë dhe janë shpallur fajtorë dhe ndaj tyre janë shqiptuar dënime me burgim dhe gjobë si në aktgjykim, por kanë pushuar se ekzistuari bazat e artikulueshme apo bazat ligjore për të cilat iu është vazhduar paraburgimi.

Kjo Gjykatë konsideron se nuk qëndron baza ligjore e parashikuar me nenin 184 par. 1 nën-par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ngase të pandehurit janë të vetëdijshëm se ndaj tyre është në zhvillim e sipër procedura penale dhe se nuk mund t'i shmangen çështjes penale ndaj tyre.

Po ashtu edhe sa i përket bazës ligjore të parashikuar me dispozitën e nenit 184 par. 1 nën-par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP-së, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhimit të masës së paraburgimit kanë përshkruar veprimet për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar, duke mos dhënë ndonjë arsye më specifike dhe konkrete tjetër përpos përshkrimit të veprimeve të të pandehurit.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj Gjykate, konform nenit 438 par. 1 pika 1.1, të KPP-së, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.728/2024, më datë 05.12.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi